



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 319, Datë 12.12.2022

MBI

MOS FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “BALKAN ENERGY TRADE” SH.P.K. NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2 gërma “d” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “e”, nenit 5, pika 1 gërma “e”, nenit 10, pikat 1 dhe 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 19 pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 12.12.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2039/6 prot., datë 07.12.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi licencimin e shoqërisë “Balkan Energy Trade” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “Balkan Energy Trade” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2015 prot., datë 30.11.2022, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.5); Shtojcën 1 dhe Shtojcën 1E të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të aplikimit (Aneksi A).
- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike në zbatim të Aneksi A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar.

- Nga aplikimi rezulton se shoqëria “Balkan Energy Trade” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të rregullores për nenin 9, pikën 1.1, gërmat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gërmat “a” dhe “d” dhe pikën 2.5.
- Nga ky aplikim rezultojnë mungesa në dokumentacionin si më poshtë:

Pika 1.2 Dokumentacioni juridik dhe administrativ

- **gërma “b”:** Aplikuesi nuk ka përcjellë Vërtetimin e Gjendjes Gjyqësore (Dëshmi Penaliteti) për vetë shoqërinë dhe administratorin e saj.
- **gërma “c”:** Aplikuesi nuk ka përcjellë informacion në lidhje me parashikimin për shtimin e stafit sipas planit të biznesit dhe nëse në strukturën e shoqërisë do të integrohet edhe staf teknik i cili do të kujdeset për tregtimin e energjisë elektrike, duke qenë se aktualisht stafi i deklaruar përbëhet vetëm nga administratori. Sa më sipër depozituar, struktura e shoqërisë vlerësohet e pa plotë.

- *Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal*

- **gërma “a”:** Shoqëria nuk ka përcjellë vërtetimin për shlyerjen e detyrimeve të sigurimeve shoqërore.
- **gërma “b”:** Në vijim të depozitimit të bilanceve për periudhën aktive të shoqërisë, konstatohet se kjo e fundit nuk ka depozituar dokumentacion në kuadër të mbështetjes financiare, ndaj vlerësohet t’i kërkohet që të depozitojë dokumentacionin referuar vlerës së investimit bazuar në planin e biznesit.
- **gërma “c”:** Në vijim shoqëria për llogaritjen e mbështetjes financiare ku të ketë garantuar të paktën një muaj të ushtrimit të aktivitetit, referuar sasisë së parashikuar nga vetë aplikuesi nuk i është referuar çmimit të bursës, për parashikimin vjetor të kostove. Gjithashtu në planin e biznesit nuk përcaktohet mënyra sesi kjo e fundit do të mbulojë financiarisht këtë plan.
- Në kuadër të mos plotësimit nga Aplikuesi të dokumentacionit thelbësor sipas kërkesave të rregullores, vlerësohet mos fillimi i procedurës për këtë aplikim.
- Në mbështetje të përcaktimeve të nenit 10, pika 7 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, në rast se shoqëria, brenda 1 (një) muaji nga marrja dijani e vendimit për mosfillimin e procedurës, paraqet në ERE dokumentacionin thelbësor të konstatuar të munguar, dokumentacioni i paraqitur për aplikimin e mëparshëm dhe pagesa për aplikim do të konsiderohen të vlefshme për fillimin e procedurës.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të mos fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Balkan Energy Trade” sh.p.k. në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike.
2. Në rast se shoqëria, brenda 1 (një) muaji nga marrja dijëni e vendimit për mosfillimin e procedurës, paraqet në ERE dokumentacionin thelbësor të konstatuar të munguar, dokumentacioni i paraqitur për aplikimin e mëparshëm dhe pagesa për aplikim do të konsiderohen të vlefshme për fillimin e procedurës.
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR

Petrit AHMETI